

University of Business and Technology in Kosovo

UBT Knowledge Center

Theses and Dissertations

Student Work

Fall 9-2017

LAJMET E RREJSHME DHE MEDIAT E REJA ONLINE

Edona Jerliu

Follow this and additional works at: <https://knowledgecenter.ubt-uni.net/etd>



Part of the [Communication Commons](#)



Kolegji UBT
Fakulteti për Media dhe Komunikim

LAJMET E RREJSHME DHE MEDIAT E REJA ONLINE
Shkalla Bachelor

Edona Jerliu

Shtator, 2017
Prishtinë



Kolegji UBT
Fakulteti për Media dhe Komunikim

Punim Diplome
Viti akademik 2014-2015

Edona Jerliu

LAJMET E RREJSHME DHE MEDIAT E REJA ONLINE

Mentori: Dr.Cand. Safet Zejnullahu

Shtator 2017

Ky punim është përpiluar dhe dorëzuar në përmbushjen e kërkesave të
pjeshme për Shkallën Bachelor

LISTA E PËRMBAJTJES

LISTA E FIGURAVE	VI
1. HYRJE	1
2. SHQYRTIMI I LITERATURËS	3
2.1 Roli dhe Sfidat e Gazetarisë.....	4
3. DEKLARIMI I PROBLEMIT	7
3.1 Çfarë është lajmi i rremë dhe si e dimë që nuk është i vërtetë?.....	7
3.2 Por, a mund t’i konsiderojmë si media të reja!?	7
3.3.1 Media të reja, por shumë dilema të vjetra	7
4. METODOLOGJIA	9
5. PREZANTIMI DHE ANALIZA E REZULTATEVE	10
5.1 Jo "lajme të rreme", por qëllimisht mashtruese	10
5.2 Lajmet e rreme, që përkulen të vërtetën.....	15
5.3 Rënia në grackë e mediave në Kosovë e Shqipëri nga lajmet e rrejshme.....	16
5.4 Mediat online pre e shtrembërimit të fakteve	19
5.5 Sondazhet e zgjedhjeve në Kosovë, lajme të rrejshme	19
5.6 Mbyllet portali i “Fake News” në Kosovë.....	20
5.7 Mobilizim i organeve përkatëse në relacion me lajmet e rrejshme	21
5.8 Shumë shtete kanë filluar të veprojnë kundër lajmit të rreme	22
5.9 Japin dorëheqje 3 gazetarë të CNN, prodhonin lajme të rrejshme	23
6. KONKLUZIONE	25
6.1 Studime rreth lajmeve të rreme.....	25
6.2 Truri i njeriut i do lajme e rreme.....	25

7. REFERENCAT	27
8. BIBLIOGRAFIA	29

ABSTRAKT

Mediat e reja ose ato sociale janë mundësi e re e gjithë atyre që tentojnë të manipulojnë me të vërtetën. Duke qenë kështu, këto media po ndryshojnë edhe mënyrën e komunikimit, njëherësh po demediatizon mediat tradicionale. Ky punim ka për qëllim të analizojë përdorimin e mediave të reja si mundësi e pastër për tentim të manipulimit me publikun. Përmes këtyre mediave, sidomos akterët politikë synojnë të prodhojnë lajme të rrejshme, kështu këta të fundit po krijojnë rrugë të cilat mundësojnë një gjë të tillë, pra “fake news”.

Përveç akterëve politikë, në krijimin e lajmeve të rreme kanë dorë edhe grupet e ndryshme të interesit, duke nisur nga kompanitë e mëdha, që në vend të shpenzimeve për reklamë, përdorin, me një çmim shumë më të lirë, mediat online, fillestare dhe me probleme financiare, për të luftuar në tregun e egër të marketingut, natyrisht jashtë rregullave fer të lojës.

Individë të caktuar, për qëllime private e politike, kanë gjetur një fushë ku më lehtë mund të depërtojnë, për të sulmuar kundërshtarët.

Krimi i organizuar, po kështu, në gjithë botën, ka shtënë në dorë shumë “media” të tilla, për të zhvilluar fushatat kundër forcave të rendit e kundër shtetit, me qëllim të mbajtjes ose krijimit të një hapësire sa më të madhe për veprim.

Për gjetjen e këtyre mënyrave viteve të fundit në mënyrë indirekte i ka ndihmuar edhe Evropa, më saktë si Kosova ashtu edhe Maqedonia e Shqipëria.

Punimi do të analizojë shembuj të lajmeve të rreme, të krijuara për një qëllim, arritjen e synimeve të projektuara.

Po ashtu, do të jepen shembuj se si Donald Trump zgjidhet president i ShBA-së. A i ndihmuan lajmet e rrejshme zgjedhjen e tij si president? Kush ra pre e qëllimit të Donald Trump-it?

Ndërkohë ekskluzivisht për këtë punim janë intervistuar edhe dy gazetarë amerikanë, të cilët kanë shprehur mendimin e tyre në lidhje më këtë fenomen, pra për lajmet e rrejshme.

Është shumë e qartë se, derisa fushëveprimi i medias së re online të rregullohet me ligje në të gjitha shtetet, hapësira për lajme të rreme do të jetë e madhe. Këtë e dinë mirë të gjithë ata që i prodhojnë këto lajme, ndaj nguten që të tilla të prodhojnë sa më shumë. Deri tash vetëm një numër i vogël shtetesh e kanë rregulluar me ligj fushën e veprimit të medias online, të tjera janë në hapat fillestarë, ndërsa në hapësirën ku jetojmë ne dhe në vendet në rajon, legjislacioni në këtë fushë lë shumë për të dëshiruar.

Ndaj, do të “furnizohemi” edhe gjatë me lajme të rreme, të prodhuara nga joprofesionistët, për qëllime të tyre personale e grupore, në interes të individëve e grupimeve të caktuara, që shpesh janë edhe individë e struktura pikërisht nga institucionet që do të duhej ta rregullojnë me ligj fushëveprimin e medias së re.

MIRËNJOHJE DHE FALËNDERIME

Realizimi i këtij studimi është arritur falë bashkëpunimit me shumë njerëz. Gjatë këtij rrugëtimit, jam bindur se çdo njeri i suksesshëm, vepron në bazë të shumë modeleve nga të cilat “trajnohesh” ose merr mësim, që do të duhen përgjatë gjithë jetës, e sidomos gjatë ushtrimit të profesionit.

Duke qenë kështu, në fillim, një falënderim shumë i madh shkon për mentorin e punimit, Dr.Cand. Safet Zejnullahu, për bashkëpunimin e vazhdueshëm dhe gatishmërinë e tij në çdo moment. Profesor Zejnullahu shërben si model profesional për gjithë studentët e gazetarisë, sepse vetëm duke ndjekur shembuj të tillë bëhet e mundur ngritja profesionale në profesion.

Po ashtu, falënderim i veçantë është për profesorin Ganimet Klaiqi, i cili u nda nga jeta para disa muajsh. Profesor Klaiqi është ndarë me neve vetëm fizikisht, por se veprat dhe këshillat e tij profesionale mbesin përherë në kujtesën time e në mendjet tona.

Njëherësh, u jam mirënjohëse dhe shumë falënderuese, gjithë profesorëve të cilët u përkushtuan dhe me dhanë kurajë në rrugëtimin tim. Në fund, por sigurisht jo më pak të rëndësishëm, falënderim i madh shkon për familjen time dhe miqtë e mi të afërt, për mbështetjen e tyre të vazhdueshme, si dhe për krijimin e kushteve të përshtatshme për realizimin me suksese të këtij studimi dhe qëllimeve të tij.

Faleminderit të gjithëve.

Edona JERLIU

Shtator, 2017

Prishtinë

LISTA E FIGURAVE

Figura 1: Publikimi i lajmit të rrejshëm për 1300 kontejnerë.....	16
Figura 2: Reagimi i ambasadës së rusisë, në shqipëri	17
Figura 3: Përgjigjja me e-mail e mark gjonaj	18
Figura 4: Kërkim falja nga drejtori i gazetës “express” për publikim e një lajmi të rremë..	19
Figura 5: Mbyllja e portalit “fake news”, në kosovë	21
Figura 6: Ilustrim/dizajn “fake news”	22
Figura 6: Logo e kompanisë mediatike “cnn”	23

1. HYRJE

“Unë nuk rrëfej. Unë nuk shpjegoj. Unë tregoj, unë ua lë personazheve të mia që të flasin në vend timin” (*Shkrimtari rus, Lav Tostoj 1904*).

Gazetaria është fushë në kuadër të së cilës mblidhen, shkruhen, redaktohen dhe publikohen informacione, e të cilat plasohen si në mediat audio-vizuale, ashtu edhe në ato të shkruara. Pra, gazetaria është një fushë profesionale dhe akademike ku përmban një sërë standardesh të cilat janë të pranuar.

Gazetaria i shërben qytetarisë e demokracisë. Konsiderohet se qëllimi kryesor i gazetarisë është që t’iu jap qytetarëve informacionet që u nevojiten për të qenë të lirë dhe të vetëqeverisen. (*B. Kovaç dhe T. Rosenstiel, 2001*).

Mediat janë komponent esencial i një shoqërie demokratike sepse mbajnë qeveritë/institucionet llogaridhënëse ndaj publikut, duke i dhënë njëkohësisht një zë të fuqishëm qytetarëve për ndikim në proceset vendimmarrëse.

Ndërkohë, mediat janë mjete komunikimi, që nga gazetatat, radiot, revistat ose televizioni. Këto mjete, konsiderohen se ndërmjetësojnë ndërmjet komunikuesve, gazetarëve, veprimtarëve për kontakte me publikun dhe komunikatorëve të tjerë dhe publikut të tyre (*Vebster*).

Gazetat, për një kohë të gjatë kanë qenë vetë sinonimi i medias. Mirëpo, ashtu siç konsiderohet se televizioni në një mënyrë “fundosi” radion, tani, portalet dhe mediat sociale po fundosin çdo ditë e më shumë shtypin e shkruar apo gazetatat. Mediat e reja ose edhe ato sociale janë teknologji e avancuar që kanë lehtësuar shkëmbimin e informacioneve përmes rrjeteve virtuale. Aktualisht janë krijuar shumë platforma interaktive, përmes të cilave individët, komunitetet dhe organizatat mund të ndajnë, bashkë-krijojnë, diskutojnë dhe modifikojnë përmbajtjet e krijuara. Por, mediat e lartpërmendura tash e sa vite ndryshuan mënyrën e komunikimit gazetaresk. Ani pse mënyra e komunikimit gazetaresk ka ndryshuar, raportimi i të vërtetës mbetet të jetë një qëllim i rëndësishëm për gazetarët profesionistë, reputacioni i të cilëve varet nga ajo.

Derisa, në pyetjen se ç'është lajmi, tregohet se kriteri që reporterët dhe redaktorët profesionist përdorin për të vendosur çfarë është lajm përmbledhet me tri fjalë: Relevanca, Dobia dhe Interesi. Këto kritere, vlejné në përgjithësi, por çdo gazetar dhe organizatë lajmesh që i përdorë ato në një kontekst specifik që u jep atyre një kuptim të veçantë. Konteksti përcaktohet nga publiku (*Missouri Group, 2005*).

2. SHQYRTIMI I LITERATURËS

Për punimin e këtij hulumtimi kam shqyrtuar shumë tekste, shembuj ose libra, të cilat më kanë shërbyer për të kuptuar në thelb problemin e lajmeve të rrejshme. Gazetaria e profesionale vazhdimisht duhet të duhej të luftohej e të ruhej si e tillë, e mos të bie pre nga lajmet e rrejshme apo propaganda. Lajmet e rrejshme po i hasim përveç në televizione, sot janë bërë pothuajse përditshmëri edhe në mediat sociale. Por, nga shqyrtimi i literaturës kuptojmë se informimi i gabuar, në parim sjell fakte të shpikura, por shpesh të maskuara si gazetari serioze. Po ashtu, kuptojmë se interneti, me theks të veçantë mediat sociale prijnë me publikimin e lajmeve të rrejshme. Lajmet e rrejshme kërkojnë pjesëmarrje aktive me pëlqime dhe shpërndarje.

Nga shqyrtimi i literaturës, kam kuptuar se lajmet e rrejshme nuk janë më problem i ri. Por, vlen të theksohet se “Fake News”, nuk kanë të bëjnë aspekt me gazetarinë apo me mediat demokratike. Lajmet e rrejshme janë problem, me të cilin aktualisht po përballen ose sfidohen mediat, si dhe kompanitë më të mëdha mediatike në botë.

Shembuj të shumtë, si në Kosovë, në rajon dhe përgjithësisht në botën moderne, kanë treguar se lajmet e rreme, në radhë të parë, janë interes i atyre që i publikojnë.

Sigurimi i klikimeve sa më të shumta është kthyer në një arenë gare pa rregulla, në të cilën ajo që pëson më së shumti është gazetaria profesionale dhe ata që dëmtohen pothuaj pariparueshëm janë mediat profesionale dhe gazetarët profesionistë, të cilët nuk priren që, për ta bërë lexuesin/shikuesin për vete, ta përdorin edhe metodën e mashtrimit, e cila po lulëzon në forma nga më të ndryshmet në median e re.

Metodat që përdoren në këtë media për mashtrim janë nga më të ndryshmet. Mashtrimi me tituj tashmë është bërë një “veprim i lejuar”, natyrisht nga përdorimi aq i tepërt dhe nga fakti se, megjithëse e dinë që po mashtrohen, lexuesit prapë klikojmë mbi ata tituj. Sa do të zgjasë kjo, mbetet të shihet. Media të caktuara vazhdojnë me këtë avaz, sado që ka përpjekje të mediave të caktuara që të ikin nga ky model “informimi”.

Një shikim i thjeshtë nga mënyra e plasimit të lajmit për marrëveshjen e Kosovës me IPA (shtator 2017) lë për të kuptuar se mbi 80 për qind e portaleve në Kosovë ende janë të pritura që ta sigurojnë “klikun” duke e bërë titullin enigmatik. “Ja sa fiton Kosova nga IPA”, “Ka q

milione fitoi Kosova nga marrëveshja IPA”, “Sa milione fitoi Kosova me marrëveshjen IPA” e tituj të tjerë të kësaj natyre shoqëruan publikimin e lajmit që Kuvendi i Kosovës ratifikoi marrëveshjen IPA, nga e cila Republika e Kosovës përfitoi 70 milione e gjysmë euro për projektet në sektorët si sundimi i ligjit, bujqësia, energjia, konkurrueshmëria dhe inovacioni, edukimi, punësimi, politikat sociale dhe mjedisi.

Vetëm një numër i vogël portalesh nuk fshehën asgjë në titull. “Kosova fiton 70.5 milione nga marrëveshja IPA” është titulli informues dhe i drejtë.

Në fakt, te kjo marrëveshje nuk kishte çka të fshihej as çka të mistifikohet, për faktin se ditë të tëra opinionimi u bombardua me njoftimet për mundësinë e humbjes së këtyre milionëve, për shkak të mospajtimeve politike në Kuvendin e Kosovës.

Është shumë më e zorshme të gjendej një qytetar i informuar mesatarisht që nuk e dinte sa para fitoheshin nga ratifikimi i kësaj marrëveshjeje. Ndaj, rrjedhimisht, numri i të mashtruarve është shumë i madh. Për fat të kaq të gazetarisë profesioniste, në dëm të medias profesioniste, me ndikim shumë të keq në besueshmërinë e profesionit pa të cilin shoqëria e ka zor të funksionojë.

2.1 Roli dhe Sfidat e Gazetarisë

Media i përmbys ndjesitë tona – të gjitha shqisat tona – të jetuarit në një botë: në një botë sociale, në një botë imagjinatave, botën e politikës globale dhe të konfrontimit (*N.Couldry, 2011*).

Mediat kanë për mision përcjelljen e lajmit deri te lexuesi. Por, në këtë mision ka një varg rregullash ose parimesh që, një media serioze ose një gazetar i mirë duhet t’i respektojë. Qëllimi kryesor i kësaj fushe, pra gazetarisë, është ta thotë të vërtetën, me qëllim që njerëzit të kenë informacionet e nevojshme për të qenë një popull sovran. Por, zhvillimi teknologjik nxjerri në pah mediat e reja, ku pati ndikim të drejtpërdrejt. Duke qenë kështu, gazetaria më nuk “udhëhiqet” nga mediat tradicionale (*J.Fuller, në forumin CCJ, në Çikago, 6 nëntor 1997*).

Me krijimin e mediave të reja është krijuar edhe mundësia për plasimin e lajmeve të rreme. Tregimet ose lajmet e rreme aktualisht po shfaqen shumë në jetën e përditshme. Ky është një problem që daton për vite me radhë, i përfshirë kryesisht në mediat e reja e që shfaqet më së

shumti gjatë zgjedhjeve elektorale. Ueb sajtet që po hapen në mënyrë të vazhdueshme, ku për qëllim pretendojnë të kenë informimin e publikut, përziejnë ose thënë saktë i shndërrojnë lajmet e vërteta në gënjeshtër. Konsiderohet që faqe të tilla nuk ekzistojnë për ndonjë arsye të veçantë, por siç e ka quajtur “The Guardian”, “për të mashtruar njerëzit”.

Propaganda në këtë mënyrë po përpiqet të detyrojë një doktrinë për të gjithë njerëzit. Si e tillë, propaganda punon për publikun e gjerë dhe në pikëpamjen e konceptit përmban një ide, andaj njerëzit propagandues punojnë për fitoren e kësaj ideje.

Janë së paku dy ngjarje të mëdha, të kohëve të fundit, që dëshmojnë sa të rënda janë sfidat e gazetarisë moderne dhe sa i rëndësishëm është roli i mediave në zhvillimin e përgjithshëm të një shoqërie dhe në mbarëvajtjen e proceseve me rëndësi nacionale e globale.

Ndërhyrja e dokumentuar tashmë e Ruisë në zgjedhjet presidenciale në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dëshmoi brishtësinë e medias online dhe rrezikun e përhershëm që dikush krejt tjetër, që ka qëndrime dhe qëllime armiqësore ndaj një shteti a një individ, të mund të ndërhyjë aq fuqishëm në një proces, edhe në shtetin më të zhvilluar në botë.

Në këtë rast ndodhi edhe paradoksi më i madh i konstatuar në një proces kaq të rëndësishëm për një vend – fitoi garën njeriu që kishte kundër të gjitha mediat kryesore në SHBA, televizionin me ndikim global, CNN, që është pjesë e çdo familjeje amerikane dhe që, është dëshmuar në shumë raste, ka pasur ndikim vendimtar në shumë procese të rëndësishme botërore, përfshirë edhe rastin e Kosovës. Ky televizion kishte rolin vendimtar në bindjen e qytetarëve dhe politikanëve në SHBA e në gjithë botën për nevojën e ndërhyrjes së NATO-s për shpëtimin e shqiptarëve të Kosovës nga gjenocidi.

Rasti i dytë ka të bëjë me Gjermaninë dhe zgjedhjet për kancelarin e këtij shteti, në shtator 2017. Duke parë atë që ndodhi në SHBA, shteti gjerman, muaj të tërë më herët, ndërmori një fushatë të gjerë të vetëdijesimit nga ndërhyrjet e jashtme në procesin zgjedhor, në përpjekje për të parandaluar që të ndodhte edhe aty ajo që ndodhi në SHBA.

U desh një vendim i Bundestagut gjerman, që shërbeu si kërcënim direkt ndaj gjithë atyre që duan të përzihen në zgjedhjet në këtë shtet, duke përfshirë sanksione të rënda financiare, për të

dekurajuar të gjithë ata që u kishte shkuar ndërmend të pasuroheshin duke prodhuar lajme të rreme, siç bënë gjatë zgjedhjeve në SHBA dhe, lirisht mund të themi, edhe në shumë shtete të tjera, por që kaluan pahetueshëm.

3. DEKLARIMI I PROBLEMIT

3.1 Çfarë është lajmi i rremë dhe si e dimë që nuk është i vërtetë?

Lajmet e rreme kryesisht tentojnë të promovojnë agjendat politike, andaj, këto lajme janë një sfidë morale sepse mund ti qojë veprimet përpara dhe ti dizajnojë si të vërteta. Por, nuk mund të zgjidhet problemi i lajmeve të rreme pa e kuptuar natyrën e tyre të vërtetë, ani pse një problem i tillë është më se e domosdoshme të eliminohet.

Qëllimi i lajmit të rremë është që të formësojë qëndrimet, perceptimet si dhe besimet e audiencës së synuar. Korporatat e quajnë atë marketing dhe e përdorin për të arritur qëllimet e veta. Por, ideja është e njëjtë. Tendenca është që të përdoret e njëjta metodologji e cila bazohet në ndikim të audiencës së targetuar.

Mediat e reja janë platformat më të mëdha për arritjen e audiencave masive, kështu hapi i parë është bindja e publikut që një lajm i rremë të duket sikur i vërtetë.

Epoka digjitale, kryesisht përmes mediave të reja, po zhvlerëson të vërtetën dhe se po shpaguehen njerëzit që po botojnë lajme të tilla në internet, derisa, artikujt e tillë janë shumë larg të së vërtetës.

3.2 Por, a mund t'i konsiderojmë si media të reja!?

Zhvillimet e fundit teknologjike ka bërë të adresohen si media të reja. Mediat e reja online janë një realitet i pamohueshëm, ku si të tilla kanë sjellë disa aspekte pozitive e disa negative. Në parim ka sjellë konkurrencën e shpejtësinë e informacionit. Në të kundërtën kanë sjellë edhe mos besueshmërinë ndaj tyre, si pasojë e plasimit të lajmeve jo të vërteta.

3.3.1 Media të reja, por shumë dilema të vjetra

Media e lirë ose profesionale përbënë një arritje të theksuar për demokracitë e vendeve, por që aktualisht të tilla korporata kanë filluar të sfidohen me ri politizim, klientelizim, si dhe reflektohen edhe nga lajmet jo të vërteta. Politika, Biznesi dhe Media janë elemente që aktualisht në Evropë dhe më gjerë përbëjnë nivel të pakënaqshëm, si dhe duke qenë kështu pasojnë lajmet e rrejshme për të përmbysur këtë nivel. Aktualisht bota po sfidohet shumë me

ushtrimin e ndikimit në media, përfshirë edhe ato sociale, me theks të veçantë po sfidohet edhe me lajmet e rrejshme.

Nëse interneti është mediumi i lajmit të së ardhmes, siç besojnë shumë njerëz, atëherë me kalimin e shumë përmbajtjeve në internet, degët e medias tradicionale do të fillojnë të pësojnë një rënie. Rrjeti online i jep industrisë së medias një mjet që bën të mundur ofrimin e audios e videos sipas kërkesës, të ndryshëm nga media tradicionale, sepse ky konsiderohet një proces evolues (*Missouri group, 2005*). Gazetaria e këtij shekulli karakterizohet me një epokë digjitale, ku sipas Shoqërisë Amerikane të Reaktorëve të Lajmeve, ka ndryshuar mënyrën se si të gjithë ne ndërveprojmë me lajme. Ata konsiderojnë se shumë të dhëna prodhohen në një sekondë të vetme, sesa mund të konsumohen gjatë jetës. Teksa, ata kanë pohuar se aftësia e një studenti për të përdorur të menduarit kritik për të analizuar kredibilitetin e raporteve të lajmeve dhe burimeve të informacionit dhe për të dalluar faktet, mendimet dhe pohimet janë shkathhtësitë thelbësore të shekullit XXI.

Po ashtu, ata deklaruan se e ardhmja e komuniteteve dhe e ardhmja e demokracisë së vendeve, varet nga qytetarët e njohur me lajme dhe nga gazetarë të trajnuar mirë, profesional, të pa anshëm, si dhe që nuk manipulojnë me publikun duke shtrembëruar faktet ose duke e fshehur të vërtetën.

Mediat sociale, arritën ta shndërrojnë informacionin në një tjetër natyrë, nga çfarë ishim mësuar ta merrnim nga mediat klasike: ai shpesh kishte natyrë më lokale, ishte i lidhur ngushtësisht me interesa të një shtrese shoqërore që nga mediat gjeneraliste kishte kohë që nuk prekej, të tilla teknika të informacionit të krijonin mundësinë e një bashkëbisedimi ndërmjet dhënësit dhe marrësit të mesazhit, gjë e cila bënte të mundur përfshirjen audiencës në të, nuk ekzistonte frika e censurës dhe manipulimit të informacionit dhe si rrjedhojë e krejt kësaj, e ndihmon gazetarin të vetë kontrollohet në punën e tij (*“Mediat e reja”, Reldar Dedaj, maj 2014*)

4. METODOLOGJIA

Ky punim synon që të prezantojë shembuj të lajmeve të rrejshme, përfshire Kosovën, Shqipërinë dhe më gjerë. Përveç kësaj, paraqitet edhe efekti i këtyre lajmeve, ndikimi dhe rënia pre e lajmeve të tilla. Andaj, për të pasur të qartë se çfarë mendojnë personat e kësaj fushe është e nevojshme që për këtë temë të aplikohet metoda kualitative. Metoda kualitative ka këto përparësi:

- 1) Të shpjegojë, të analizojë dhe të verifikojë idetë, të përshkruajë situatat, emocionet dhe të interpretojë sjelljet;
- 2) Është fleksibile për të lejuar ndryshimin e pyetjeve, gjë që mundëson një diskutim më përmbajtjesor me të intervistuarin;
- 3) Nuk është metodë e standardizuar ku të dhënat mblidhen në një formë të integruar;
- 4) Pra, synon të interpretojë teorinë me konceptet në këtë fushë, përvojat dhe situatat e tjera dhe i ndërlidh me Kosovën. Të dhënat janë bazuar në burime relevante që kanë të bëjnë me hulumtimin. Hulumtimi është bërë përmes intervistave me profile të ndryshme që kanë të bëjnë me fushën përkatëse si dhe hulumtim nga literatura të ndryshme.

5. PREZANTIMI DHE ANALIZA E REZULTATEVE

5.1 Jo "lajme të rreme", por qëllimisht mashtruese

Publikimi i lajmeve të rreme kufizojnë padrejtësisht ushtrimin e lirisë së mendimit dhe shprehjes. Në kuadër të kësaj dispozite, lajmet e rreme mund të shkaktojnë kërcënime dhe trazira publike (*Këshilli i Kombeve të Bashkuara për të drejtat e njeriut, Deklaratë për lirinë e shprehjes dhe lajmet e rrejshme, dezinformimi dhe propaganda, mars 2017*).

Deri disa vite më parë, studiuesit e kësaj fushe konsideronin se ishte e lehtë të kuptohej nëse një lajm është i rremë apo jo. Por, sipas tyre, tani sipas tyre gjërat kanë ndryshuar, madje, lajmi i rrejshëm paraqitet në atë mënyrë sa që njerëzit e kanë të vështirë të dallojnë mes rrëfimeve të rreme dhe reale. Lajmet e rreme janë citime që nuk u thanë asnjëherë ose ngjarje që nuk kanë ndodhur kurrë.

Steven N. Czetli, (*bisedë personale me e-mail, gusht 2017*), gazetar në ShBA, redaktor, njëherësh edhe autor i shumë librave ka theksuar se sot në parim lajmet e rreme krijohen me lehtësi, si dhe të tilla lajme, sipas tij, i drejtohen një audiencë masive pothuajse pa asnjë kosto.

“Sot të tilla lajme, hapin derën për adoleshentët e çmendur që kërkojnë vëmendje. Për kompanitë që të shesin dhe ofrojnë prodhime dhe shërbime. Qeveritë që të kërkojnë të ndikojnë opinionin publik, thënë ndryshe (propaganda)”, ka thënë Czetli.

Po ashtu, Donna Halper, (*bisedë personale me e-mail, gusht 2017*) profesoreshë e gazetarisë në ShBA, njëherësh edhe njohëse e historisë së gazetarisë, si dhe autore e shumë librave të kësaj fushe, theksoi se lajmet e rrejshme krijohen vetëm për të mashtruar publikun ose për klikime.

“Pra, po ‘lajmi i rremë’ mund të jetë vërtet një formë e dezinformimit ose një përpjekje për të na manipuluar. Ose mund të jetë vetëm një shembull i njerëzve që duan ta mashtrojnë publikun (për shembull, klik-karrem). Kështu, na takon si konsumatorë lajmesh për të përdorur sensin, logjikën dhe skepticizmin e përbashkët, kur ne papritur shohim një histori që ka për qëllim të na sulmojë; Është e rëndësishme të kërkojmë faktet aktuale (jo vetëm ato që përforcojnë atë që ne tashmë i besojmë)”, tha Halper.

Lajmet e rreme artikuloohen në formë të satirës ose si mashtrime të qëllimshme, por shkencëtari i kompjuterit Filippo Menczer ka theksuar se të tilla lajme të bujshme, si dhe fushatat e mediave sociale kanë shumë të meta thënë kushtimisht. Të metat e lajmeve, duke filluar edhe me shtrembërimin e fakteve të vërteta filluan qysh nga viti 2010.

"Kjo është hera e parë që kemi filluar të studiojmë në mënyrë aktive, dhe në atë kohë gjetëm disa raste të faqeve që botonin lajme krejtësisht të rreme dhe të fabrikuara, thjesht për propagandë politike", ka thënë Menczer, i cili harton algoritme për të përcjellë mesazhet politike si drejtor i Qendrës së Universitetit të Indiana për Rrjetet Komplekse dhe Kërkimet e Sistemeve(*Pbp.org, dhjetor 2016*).

Trendet e lajmeve, të rreme apo edhe reale, sipas tij, 'vuajnë' për atë që quhet ekonomia e vëmendjes, ku nëse njerëzit i kushtojnë vëmendje një teme të caktuar, do të prodhohen më shumë informacione për këtë temë.

Megjithatë, demokracia e shumë shteteve në botë ka qenë vazhdimisht e goditur nga ndryshimet në teknologjinë e medias. Në kuadër të zgjedhjeve të fundit presidenciale në ShBA, efekti i lajmeve të rrejshme ishte i madh. Kështu, shqetësimi kryesor ka qenë që këto lajme burojnë nga mediat e reja, përfshirë edhe ato sociale. Pavarësisht nga historia e lajmeve të rreme, ka disa arsye për të menduar se lajmi i rremë është në rritje, kjo ngaqë, mediat sociale janë të përshtatshme për shpërndarje të rreme të lajmeve.

Duke qenë kështu, një numër i madh i analistëve politik në botë kanë theksuar se presidenti aktual i ShBA-së, Donald Trump nuk do të ishte zgjedhur president nëse nuk do të kishin pasur ndikimin pikërisht lajmet e rreme pro-Trump. Në zgjedhjet e fundit presidenciale më 2016 në ShBA, Donald Trump u zgjodh si president kjo si pasojë e lajmeve të rreme, të mundësuar nga zhvillimi i teknologjisë, nga interneti e sidomos nga rrjetet sociale. Trump u zgjodh president, ani pse haptazi ishte kundër pothuajse të gjitha mediave më me ndikim në botë. Ai ishte kundër edhe kanalit televiziv më të fuqishëm në botë "CNN". Kjo e fundit, i zbuloi afërsisht të cilat ishin propaganduar nga vetë Trump, duke transmetuar kështu vetëm lajmet negative për të. Fushatës së CNN iu bashkuan edhe televizionet e pothuajse gjitha mediumet tjera, gjë e pa ndodhur ndonjëherë më parë në ShBA, kjo vetëm që t'i pamundësohet atij të bëhet president.

Trump ndërkohë angazhoi se një strateg digjital, Brad Parscale, ekspert informatike nga San Antonio. Brad arriti të mbledhë e-maillet e 12-14 milionë njerëzve që shkëmbente me ta gjithçka; dëshirat, kërkesat por edhe pyetjet e sakta se për kë do të votojnë. Por më vonë nga këto adresa u morën edhe para për donacione, që ishte më shumë sesa para, një besim i hapur dhe i lidhur tashmë. Mirëpo, Brad nuk ishte çelësi kryesor i fitores së Trump. Në teknologji informative, pavarësisht superioritetit të ShBA-së, në lojërat e ndyta në këtë fushë primatin e mbajnë rusët. Hetimet e zhvilluara po tregojnë qartë përzierjen ruse në zgjedhjet amerikane, një element që u theksua në vazhdimësi, por filli i të cilit po zgjidhet vetëm muaj të tërë pas zgjedhjeve. Megjithatë, përkrahja vullnetare ose e paguar ndaj Trump, si dhe mashtrimet kundër kandidatës, Hilary Clinton, nuk u bënë në ShBA, por as në Rusi.

Në prag të zgjedhjeve presidenciale në ShBA, “The Guardian”, dhe jo vetëm, zbuluan se shumë shtete në botë janë duke prodhuar lajme të rreme në favor të kandidatit aktualisht presidentit Donald Trump. Në mesin e këtyre shteteve rezultoi të jetë edhe Maqedonia. Kanali amerikan “Channel 4”, gjurmoi vendin dhe autorët e këtyre faqeve. Dhe gjurmimi i ka çuar në një “minifabrikë” lajmesh në Maqedoni. Rreth 200 të rinj nga qyteti i Velesit në Maqedoni dhe rrethina e këtij qyteti, kishin hapur ueb faqe të shumta për plasimin e lajmeve pro-Trump. Derisa, me punën që bënin, ata fituan së paku 200 mijë dollarë. Lajmet e tyre pro Trumpit dhe kundër Klintonit janë shpërndarë më shumë se 250 mijë herë. Këto faqe u titulluan në atë mënyrë sa që në pamje të parë të ngjajnë tërësisht në faqe amerikane. Si për shembull: Usa News Flash, Usa Online Politics etj. Madje, njëra nga faqet ka arritur mbi gjysmë milioni ndjekës. Ndërkohë, fushata elektorale e Donald Trump, ishte shans i artë për këta të rinj të papunë.

I riu nga Maqedonia, i ashtuquajtur Viktor, i përfshirë në këtë histori, e që është intervistuar nga kanali “Channel 4”, ka theksuar se historitë e Donald Trump janë ndjekur e njëherësh janë pëlqyer shumë. Duke qenë kështu, platformat sociale Facebook dhe Tëitter, u akuzuan për plasimin e lajmeve të rrejshme, si në rastin me Maqedoninë. Derisa, këto të fundit i morën seriozisht akuzat në fjalë, si dhe kërkuan ndalimin e informacioneve të rreme.

“Dukuria e lajmeve të rrejshme është e pranishme në disa nga mediat në Maqedoni, por ajo është një dukuri botërore për të cilën diskutohet gjithnjë e më shumë dhe kërkon masa dhe zgjidhje, duke pasur parasysh implikimet që krijon dukuria e tillë e shpalljes së informatave të

pavërteta, gjë që është e ndryshme nga propaganda dhe dezinformata” (*Marija Tuneva, drejtore ekzekutive e Këshillit për etikë në mediat e Maqedonisë, Telegrafi.com - shtator 2017*).

Kandidatja për kryetare të ShBA-ve, Hillary Clinton, duke komentuar arsyet e humbjes së garës për president, kishte deklaruar se shpërndarja e lajmeve të rreme për të nga portale interneti nga Maqedonia, kanë ndikuar në humbjen e saj në nëntorin e vitit të kaluar. Ajo kishte theksuar se hakerë nga Rusia i kanë lexuar porositë e saj në e-mail dhe i kanë shpërndarë përmes portaleve të regjistruara në Maqedoni (*Qershor, Telegrafi- Maqedoni, 2017*).

Por, në mesin e shumë vendeve që me lajme të rreme që përkrahën zgjedhjen e Donald Trump për president është edhe Kosova. Të rinjtë kosovarë vepruan pothuajse njësoj sikur ata të qytetit të Velesit në Maqedoni.

Këtë më së miri e dëshmon artikulli i gazetarit Vincent Triest me titull: “Si u pasuruan 11 portale shqiptare me sulmet ndaj Hillary Clintonit”. Në këtë shkrim, Triest zbuloi se këta të rinjtë kishin hapur faqe të ndryshme në Kosovë, por që ishin të regjistruara në Shqipëri.

“FBI do të publikojë prova të reja për rrjetin e pedofilisë që ka lidhje me Hillary Clinton”, ishte kjo tema kryesore e një shkrimi në uebsitin Bients.com dhe ThePredicted.com. Duke cituar një dokument të fabrikuar të FBI-së, shkrimi implikonte ish-kandidaten demokrate për presidente të Amerikës me një krim shumë të rëndë. Pavarësisht se lajmi nuk kishte asnjë fakt a provë, ai u klikua dhjetëra mijëra herë dhe mori mijëra like në rrjetin social “Facebook” (*Triest, prill 2017*).

Në këtë rast, i riu kosovar, Hysen Alimi, që ka studiuar “Menaxhim dhe Informatikë” në Universitetin “Kadri Zeka” në Gjilan, ishte administrator i të paktën njëmbëdhjetë portaleve të fokusuara në politikën amerikane, ani pse nuk e njihnte edhe aq mirë gjuhën angleze. Por, kjo nuk u bë pengesë për të zotëruar portalet si **Bients.com**, **ThePredicted.com**, **PoliticsBreaking.com** dhe **BernieMyHero.com**, të regjistruara të gjitha në Shqipëri.

Ueb faqen që ai zotëronte morën mijëra klikime, derisa, Bients.com merrte mbi 200 mijë klikime në kohën e fushës zgjedhore në Amerikë. “Për këtë ai fitonte rreth 400 euro në ditë”. Kështu së paku thuhet në artikullin hulumtues të lartpërmendur. Faqet shpërndanin kryesisht

lajmet pro-Bernie Sanders duke targetuar persona të zhgënjyer nga Hillary Clinton. Senatori Sanders ishte kundërshtari kryesor i ish-sekretares dhe kandidates për presidente Hillary Clinton. Baza elektorale të Sanders ishin kryesisht votues të ri dhe studentë, të cilët përdoren rrjetin social "Facebook" si një mjet të rëndësishëm për të organizuar fushatën dhe një mjet për t'u informuar për lajmet të fundit mbi skenën politike në Amerikë, shkruajnë mediat në Kosovë.

Në intervistë, që ishte publikuar në qindra media në botë, Hyseni kishte thënë se ishte një mundësi e artë për të krijuar një 'fan page' për senatorin Sanders, në tentativë për të tërhequr sa më shumë militantë në faqet e tij. Dhe jo pa sukses. Faqja u krijua në mars të vitit 2016 dhe ndiqet sot nga 86 mijë persona në rrjetin social Facebook. Në këtë faqe, përveç fotove të senatorit Bernie Sanders, shpërndahen dhe lajme të rreme apo "fake news" nga Hysen Alimi, citojnë mediat kosovare.

"Gazeta Shqiptare", kishte kontaktuar me e-mail me Hysen Alimin, i cili kishte thënë se faqet janë në pronësi të tij, si dhe burimet që shfaqen në lajme janë legjitime.

"Ne thjesht kemi një 'uebfaqe' për mbështetësit e Bernie Sanders dhe lajmet janë të vërteta. Ne jemi thjesht një fan page". I pyetur se sa vetë e administronin këtë faqe, Alimi u përgjigj: "Nuk dua ta tregoj" (Alimi, prill 2017).

Gazetari amerikan John Mattes, i cili ka hulumtuar çështjen e lajmeve 'fake' dhe impaktin e lajmeve të sajuara në zgjedhjet amerikane, tha për "Gazetën Shqiptare" se "është e çuditshme që një njeri pa njohuri në politikën amerikane krijon disa faqe për të mbuluar këtë temë".

Mattes, po ashtu tha që "Hyseni ishte një person i rëndësishëm në 'rrjetin' që shpërndante lajme të trilluara për militantët e Bernie Sanders, pasi ai administronte një nga faqet me të mëdha në "Facebook" të fansave të tij".

"Përse një person me disa faqe në Shqipëri, krijon një 'fan page' duke pretenduar që faqja ndodhet në Amerikë?" (Mattes, prill 2017).

Megjithatë, historia e lajmeve të rreme në kuadër të kësaj fushate presidenciale nuk mbaroi me kaq. Në këtë histori u futën edhe kosovarë të tjerë. Në mars të vitit 2017, gazeta "Zëri" raportoi se për një histori mashtrimi me një citat të rremë nga Sekretari për Shëndetësi dhe Shërbimeve

Njerëzore, Tom Prince, ku ka frymëzuar zemërimin dhe urrejtje në të gjithë Facebook-un. Ky zyrtar i Trumpit nuk tha, "Është më mirë për buxhetin tonë nëse pacientët me kancer vdesin më shpejt". Lajmi e ka origjinën nga portali që sjon lajme të rreme, **USPoln.com** (*Zëri, mars 2017*).

USPoln.com është një ueb-faqe që boton lajme të rreme. Ky mashtrim hutoi lexuesit për shkak se një ndër artikujt fillon me citimet reale të një interviste që Price kishte me CNN.

USPoln.com është faqe në pronësi nga personi me emrin Behar Beqiri, i cili, sipas të dhënave nga "DomainTools" jeton në Kosovë.

5.2 Lajmet e rreme, që përkulen të vërtetën

Revista italiane "Pianeta Italia" ka publikuar investigimin se si 1300 kontejnerë me mbetje të rrezikshme të nisura nga Italia me destinacion në Maqedoni për t'u përpunuar, janë zhdukur në Shqipëri ku dyshohet se janë groposur. Revista italiane ka publikuar dokumentet e marrëveshjes italo-maqedonase që tregojnë rrugëtimin e kontejnerëve me mijëra tonelata mbetje, të cilat do të kalonin transit nga Shqipëria përmes portit të Durrësit. Është fakt se korridori me interes për eksportin e mbetjeve në atë zonë është ai që të çon në Qafë Thanë, në kufirin Shqipëri-Maqedoni dhe prej andej në landfillin e Drislla, Shkup. Ky landfill është më i madhi në Evropë.

Kompania që ka marrë përsipër përpunimin e mbetjeve, ajo e sipërmarrësit "Ferazzoli" sigurisht që nuk do të investonte 73 milionë euro për asgjësimin e mbetjeve, dhënë nga administrata e dobët dhe pa burime të mjaftueshme. Biznesi i vërtetë, pa dyshim që të bën të mendosh se zinxhiri i eksportit nuk është vetëm nga Italia, por edhe vende të tjera evropiane. I njëjti zinxhir që tashmë është objekt i hetimit nga anti-mafia në Itali, Maqedoni dhe Shqipëri. Një shembull për të gjithë, Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama tha gjatë fushatës zgjedhore se Shqipëria nuk do të bëhet asnjëherë vendgrumbullim i mbetjeve të Evropës. Por, në kundërshtim me veten e tij, në 2016 paraqiti një projektligj që lejonte importin e mbetjeve.



E adesso che la Macedonia non consente lo scarico di rifiuti stranieri nella discarica di Drisla e che l'Albania si oppone

Figura 1: Publikimi i lajmit të rrejtshëm për 1300 kontejnerë

Por kjo sipas Prokurorisë është e pavërtetë, si dhe lajm i rrejtshëm. “Nuk ka ndonjë hetim lidhur me sa pretendohet në një shkrim të shpërndarë pasditen e sotme, lidhur me hyrje të mundshme në mënyrë të paligjshme të kontejnerëve me mbeturina. Gjithashtu, në takimin ndërmjet Prokurorit të Përgjithshëm, Adriatik Llalla dhe Drejtorit të Antimafias Italiane, Franko Roberti, nuk është diskutuar një çështje e tillë”, kështu është deklaruar Prokuroria e Përgjithshme në Shqipëri (Syri.net, mars 2017).

5.3 Rënia në grackë e mediave në Kosovë e Shqipëri nga lajmet e rrejshme

Në qershor të vitit 2017, mediat si në Kosovë ashtu edhe në Shqipëri ranë në grackë të lajmeve të rrejshme. Shumë shpejt bëri bujë lajmi me titull: **“Rusia ka blerë një televizion dhe tre portale në Tiranë”**, ku lajmi fliste për një deklaratë të bujshme të Mark Gjonajt, asamblist në New York. Sipas lajmit në fjalë, Shqipëria është pjesë e një projekti të quajtur **“New – Alb – Transfert Media Contract”**, që synon të ndikojë në opinione publike përmes blerjes dhe përdorimit të mediave.




Figura 2: Reagimi i ambasadës së rusisë, në Shqipëri

Lajmi në fjalë u publikua menjëherë tek të gjitha mediat në vend dhe më gjerë. Nga kërkimi në ‘Google’ rezultoi se ky lajm ishte në shumë portale të tjera të huaja. Në portale të ndryshme lajmi kishte veç një burim: emrin Mark Gjonaj, personi që supozohej se ka bërë deklaratën. Kështu, gazetarët i dërguan një e-mail në adresën zyrtare të këshilltarit Mark Gjonaj (GjonajM@nyassembly.gov), ku shtrohen pyetjet rreth deklaratës që qarkullonte në media. Përgjigja zyrtare erdhi shpejt. Gjonaj mohoi deklaratën që është shpërndarë në portale, i cili tha se është lajm i rremë, si dhe duke qenë kështu ai kërkoi të fshihej menjëherë një artikull të tillë.

Mark Gjonaj
Bronx, NY, 10461
15 Qershor, 2017

Drejtuar Editoreve/Botuesve dhe gazetarëve:

Po ju shkruaj në lidhje me një artikull të botuar ditëve të fundit në portale të ndryshme: "Rusia ka blerë një televizion në Shqipëri dhe tre portale, së shpejti edhe një gazetë" me 14 Qershor, 2017 ku identifikohem si Asambleist i Shtetit të New Yorkut.

Dua të beje të ditur publikisht dhe kategoriisht se as une dhe as dikush në emrin tim, nga zyra ime e Asamblese apo e Fushatës, nuk ka shkruar një artikull të tillë, nuk ka dhënë interviste dhe as ka komentuar në lidhje me këtë çështje.

Si mjedhoje, kërkoj që menjëherë ky artikull i fabrikuar të hiqet nga faqja juaj në internet dhe të ndalohet shpërndarja dhe l i këtyre lajmeve të fabrikuara dhe të rreme dhe gjithashtu kërkoj që të botohi një përgjigje të këtyre deklaratave.

Ju lutem konfirmoni që e keni marrë këtë korrespondencë dhe kërkoj reagimin tuaj të shpejtë dhe konfirmimin tuaj që do të veproni në përputhshmëri me kërkesat që ju janë bërë në këtë email.

Sinqerisht,

Mark Gjonaj
Asambleist i Shtetit të New Yorkut.

Figura 3: Përgjigja me e-mail e mark gjonaj

Në vitin e kaluar, në prill të vitit 2016, Gazeta on-line Express në Kosovë, kishte publikuar një artikull i cili shumë shpejt bëri bujë, se kinse kryetari i Prishtinës Shpend Ahmeti, kishte punësuar djalin e aktivistit të Vetëvendosjes, pra djalin e doktorit Jusuf Ulaj, në një pozitë komunale. Por, lajmi në fjalë doli të jetë i rremë.

Pas shumë reagimeve për lajmin, vetë drejtori i gazetës, Berat Buzhala përmes një komunikatë për media, ku përveç që ka kërkuar falje publike, kishte deklaruar se gazetari i gazetës ka mashtruar opinionin publik, si dhe informatat që janë publikuar në lajm janë të pavërteta.



Figura 4: Kërkim falja nga drejtori i gazetës “express” për publikim e një lajmi të rremë

5.4 Mediat online pre e shtrembërimit të fakteve

Për shumë pak minuta bëri bujë lajmi tjetër në Kosovë, se Adem Grabovci i Partisë Demokratike të Kosovës, kishte dalë për kafe me Glauk Konjufcën, si dhe Sami Kurteshin e Lëvizjes Vetëvendosje. Në fakt, e vërteta ishte larg prej asaj që raportohej.

Pas pak minutash nga publikimi i lajmit, u demantua një gjë e tillë, sepse Adem Grabovci ishte ngatërruar me deputetin e legjislativave të mëhershme, Driton Tali.

“Kjo është gënjeshtër absolute”, kishte thënë Kurteshi. Lajmi më pas është fshirë nga të gjitha mediat, ngaqë ishte një huqje totale ose edhe një lajm i rrejshëm (*lajmi.net, maj 2017*).

5.5 Sondazhet e zgjedhjeve në Kosovë, lajme të rrejshme

Një ueb-faqe “Fushata2017”, e hapur në kuadër të zgjedhjeve, ka shpërndarë një lajm të rrejshëm për një sondazh. Kjo ueb-faqe e ka shkruar një lajm të rremë duke treguar për rezultatet

e një sondazhi duke u thirrur në Institutin “Gani Bobi”. Ky sondazh tregon për një garë të ngushtë në mes të koalicionit PDK-AAK-NISMA dhe Lëvizjes Vetëvendosje, ndërsa me shumë më pak vota e rendit koalicionin e udhëhequr nga LDK-ja. Ueb-faqja është sponsorizuar edhe në rrjetin social “Facebook”.

Shkelzen Maliqi tha se Instituti “Gani Bobi” nuk punon fare dhe nuk ka publikuar asnjë sondazh. Ai tha se lajmi i publikuar është i rremë, si dhe kërkoi që të fshihej.

“Gani Bobi” nuk punon fare, është e rreme, është “fake news” edhe nuk guxojmë me shpall exit-pollin (sondazhe) para se të mbyllen të gjitha vendvotimet. Por, vlen të theksohet se “Gani Bobi”, si institut nuk është më funksional, është shuar që një kohë të gjatë”, tha Maliqi. (*Kallxo.com, qershor 2017*).

5.6 Mbyllet portali i “Fake News” në Kosovë

Si rezultat i lajmeve të rrejshme që prodhonin, me theks të veçantë për kundërshtarë partiak në Kosovë, në qershor të vitit 2017, mediat në vend raportuan se portali “Kosovasot.live” që shpërndante lajme të rrejshme duke cituar mediat e tjera ishte mbyllur. Pas hulumtimit të parë që bëri Indeksonline se pas kujt qëndron ky portal që po prodhonte lajme jo të vërteta dhe në dëm të disa subjekteve politike, thuhet se aktivistë të Vetëvendosjes qëndronin prapa këtij portali.

Më pas rasti u raportua edhe në organet e drejtësisë në Kosovë, për shkak se ky portal shpërndante lajme të rrejshme duke cituar edhe portalin “Indeksonline”. (*11 qershor 2017, Zëri*)



Figura 5: Mbyllja e portalit “fake news”, në Kosovë

5.7 Mobilizim i organeve përkatëse në relacion me lajmet e rrejshme

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut në Strasburg kishte marrë një vendim, që mediat online në Kosovë e Shqipëri të disiplinohen dhe të kufizojnë komentet e lexuesve, një hapësirë kjo që për vite të tëra shërbeu për gjithçka tjetër, por jo për komentet normale për përmbajtjen e një lajmi të caktuar.

Në qershor 2015, kjo gjykatë vendosi me 15 vota pro dhe dy kundër që t’u thotë jo komenteve denigruese dhe fyese në mediat online. Vendimi u mor pasi gjykata shqyrtoi një rast mes të përditshmet estoneze, “Delfi AS”, e cila ishte dënuar me 320 euro gjobë nga një gjykatë në Estoni, pasi nuk fshiu komentet fyese të lexuesve në portalin e saj ndaj një kompanie tragetesh. Gjykata e të Drejtave të Njeriut çmoi se gjoba prej 320 eurosh ishte e papërfillshme në krahasim me dëmin që i kishin shkaktuar komentet fyese kompanisë së trageteve.

E përditshmja estoneze i fshiu komentet vetëm 6 javë pasi ato u publikuan në mars të 2006. Gjykata e Strasburgut argumentoi se fshirja e komenteve është përgjegjësi e menaxherëve të mediave online. Heqja e tyre është e detyrueshme pasi shkakton dëme dhe nuk e cenon lirinë e

shprehjes. Por, deri në këtë vendim, rubrika e komenteve në mediat sociale u bë një fushëbetejë për të gjitha llojet më të rënda të fyerjeve, sharjeve, etiketimeve, denigrimeve e shantazhit.

5.8 Shumë shtete kanë filluar të veprojnë kundër lajmit të rreme

Franca, Gjermania si dhe Bashkimi Evropian, në bashkëpunim me kompanitë udhëheqëse të teknologjisë dhe mediave sociale, po ndërmarrin veprime kundër fenomenit të lajmeve të rreme.



Figura 6: Ilustrim/dizajn “Fake News”

Gjermania “kërcënoi” Facebook-in që do të përballet me probleme të shumta nëse nuk vepron për të luftuar lajmin e rremë, derisa, BE-ja ka paralajmëruar rritjen e lajmeve të rreme dhe se është duke i mbështetur përpjekjet për të kontrolluar e bllokuar një fenomen të tillë. Ministri gjerman i Drejtësisë, Heiko Maas, hartoi një projektligj, që synon vendosjen e gjobave si pjesë e përpjekjeve për të mbikëqyrur bisedat apo publikimet “helmuese”. Ky propozim u nis nga fakti se përpjekjet vullnetare të rrjeteve sociale për të zgjidhur problemin e lajmeve të rreme nuk kanë qenë të mjaftueshme. Ministri shtoi më tej se masa për të luftuar fjalimet e urrejtjes dhe të ashtuquajturat “fake news” do të duhet të ngrihet në nivel evropian që të jetë edhe më shumë efektive.

Përderisa, ministria kërkoi nga faqet “online” që të ofrojnë linja ndihmëse 24, njëherësh tha se kanë paraparë të vendosin gjoba të rënda për kompanitë që lejojnë publikimin e lajmeve të

rrime, në vlerë deri në 50 milionë euro. Kabineti i drejtuar nga Kancelaria Angela Merkel ra dakord në prill të këtij viti, mbi rregulloren që do të vendosë gjoba deri në 50 milionë euro ndaj rrjeteve sociale që dështojnë të heqin në mënyrë të shpejtë materialet ilegale, siç janë fjalimet me baza urrejtjeje apo lajmet e rreme shpifëse dhe denigruese. Duke qenë kështu, platforma sociale “**Facebook**” nuk komentoi ligjin në fjalë, por kishte treguar se testimet që kanë kryer, konsiderojnë se rrjeti ka hequr një përqindje të madhe të përmbajtjeve të lartë cekura. Ndërkohë, këta do të rritin numrin e të punësuarve deri në 700 persona, vetëm për t’u angazhuar në përpjekjet për të shqyrtuar të tilla materiale.

Ndërkohë edhe në vitin 2015, Gjermania bëri presion rrjeteve Facebook, Twitter dhe YouTube e Google për të nënshkruar një kod sjelljeje, e cila përfshinte një premtim për të fshirë fjalimin e urrejtjes nga faqet e internetit brenda 24 orëve.

“Ne mund të bëjmë më tepër se sa t’i japim komunitetit tonë mundësinë për të njoftuar për lajmet e gabuara dhe të gënjeshtër” (*Janar 2017, Mark Zuckerberg*).

5.9 Japin dorëheqje 3 gazetarë të CNN, prodhonin lajme të rrejshme



Figura 6: Logo e kompanisë mediatike “CNN”

Pas mobilizimit që organeve përkatëse për evitimin e lajmeve të rrejshme, pikërisht në qershor të vitit 2017, tre gazetarë të shquar të ‘CNN’ dhanë dorëheqje, pasi që kjo media fillimisht

tërhoqi dhe më pas kërkoi falje për shkak të tekstit të botuar në ueb faqen e saj për lidhjet ndërmjet fondit të investimeve ruse dhe bashkëpunëtorit të afërt të presidentit Donald Trump, raportojnë mediat amerikane. Artikulli, i cili raportonte se Kongresi po hetonte lidhjet e fondit të investimeve ruse me zyrtarët e Trump, kishte cituar burime anonime, e i cili artikull nuk arriti të faktohet. Dorëheqje kanë dhënë Thomas Frank, autor i tekstit, Lex Haris, udhëheqës i redaksisë për hulumtime të gazetarisë dhe Eric Lichtblau, redaktori i njësisë (27 qershor, “*New York Times*”, 2017).

6. KONKLUSIONE

6.1 Studime rreth lajmeve të rreme

Në konferencën shkencore të mbajtur në shtator të vitit 2017, në Prishtinë, me temë: “Historia e medias dhe transformimet mediatike”, u tha se Kosova, Shqipëria dhe Maqedonia po përballen me problemet e njëjta mediatike, sikur ato të vendeve të BE-së, përfshirë edhe Italinë. Madje, sipas profesorit italian, Rolando Marini, shqetësuese mbetet fakti se si të fuqizohet shoqërimi dhe bashkë ndarja e vlerave në komunikimet online dhe mediat sociale.

Në anën tjetër, profesoresha maqedonase, Snezhana Trajkovska, në këtë konferencë theksoi se problemi në mediat ballkanike, vazhdon të mbetet përfshirja e madhe politikës në industrinë mediatike dhe kontrolli që ushtrohet nëpërmjet njerëzve të infiltuar në media. Sipas saj, këta njerëz nëpërmjet financimeve të ndryshme, kanë arritur të ushtrojnë politika mbi mediat. Andaj, në këtë mënyrë sipas saj, publiku sot nuk po arrijnë të dallojë informacionin e vërtetë nga informacionet e rrejshme, lajmet e manipuluar apo propaganda.

Derisa, profesori nga Tirana njëherësh pjesëmarrës në këtë konferencë, Ramadan Çipuri, kishte theksuar se është koha që Shqipëria në bashkëpunim me Kosovën të punojnë në hartimin e një teksti edukues mediatik dhe kjo të bëhet pjesë e kurrikulave të arsimit para universitar.

6.2 Truri i njeriut i do lajme e rreme

Psikologu Dannagal Young, ka fajësuar lexuesit për përhapjen e lajmeve të rreme, sepse sipas tij, nga një perspektivë njohëse, është disi ekuivalente dhe është njëjtë sikur të fajësohet fëmija për ndotjen. Kjo largpamësi vjen pas një dekade të studimit se si mendja njerëzore i përgjigjet satirave politike. Satira është ndoshta dallimi më i përhapur i lajmeve të rreme dhe ndoshta më i miri studiuar. Përpunimi mental i satirës është unik në krahasim me llojet e tjera të informacionit, tha Young, sepse kërkon pjesëmarrjen e audiencës.

"Pra, krahasuar me atë që shohim në komunikimin tradicional, ekziston kjo vëmendje e shtuar, interes i shtuar dhe përpunim i shtuar që ndodh", tha Young, i cili punon në Universitetin e Delaware. "Pra gjërat që dëgjoni në kontekstin e humorit do të jenë më shumë në krye të mendjes suaj".

Këto ditë, problemi vjen nga njerëzit që nuk janë në gjendje të njohin ironi në satirë online, theksoi Young. Ai ofroi shembullin e një peticioni të fundit të Change.org, “Lejo Hapjen e Armëve të Zjarrit”, në Arena Quicken Loans gjatë të një konvente . Peticioni u shkrua sikur të ishte i vërtetë, si dhe mediat e lajmeve si ‘USA Today’ e publikuan lajmin, por autori i tij për kontrollin e armëve ishte në të vërtetë duke u përpjekur të portretizonte atë që ai e shihte si hipokrizi nga politikanët konservatorë (*Bps.org, dhjetor 2016*).

Megjithatë, lufta kundër lajmit të rremë nuk është duke u zhvilluar vetëm nga Google, Facebook dhe kompanitë e mëdha të medias. Kësaj beteje i janë bashkuar edhe akademikët dhe shkencëtarët e të dhënave, që filluan punën në këtë drejtim para se të ndodhnin lajme të rreme, që dyshohet shumë se ndihmuan në ndikimin e zgjedhjeve presidenciale të vitit 2016 në shumë vende e posaçërisht në ShBA. Puna e tyre ka dhënë rezultate që ndihmojnë në gjetjen e "fakteve alternative", të cilat i qojnë në identifikimin e tregime të rreme, si dhe është duke u bërë përpjekje për t'i bllokuar ato krejtësisht, ose së paku për të penguar përhapjen e tregimeve të tilla.

7. REFERENCAT

Steven N. Czetli, (*bisedë personale me e-mail, gusht 2017*) gazetar në ShBA, redaktor, njëherësh edhe autor i shumë librave.

Donna Halper, (*bisedë personale me e-mail, gusht 2017*) profesoreshë e gazetarisë në ShBA, njëherësh edhe njohëse e historisë së gazetarisë, si dhe autore e shumë librave të kësaj fushe.

Këshilli i Kombeve të Bashkuara për të drejtat e njeriut, Deklaratë për lirinë e shprehjes dhe lajmet e rrejshme, dezinformimi dhe propaganda, mars 2017.[Online]

http://www.ohchr.org/_layouts/15/ËopiFrame.aspx?sourcedoc=/Documents/Issues/Expression/Join%20Declaration3March2017.doc&action=default&DefaultItemOpen=1

Konferenca shkencore për komunikim dhe media, Prishtinë shtator 2017.[Online]

<http://www.insajderi.com/mbylli-punimet-konferenca-shkencore-nderkombetare-per-komunikimet-dhe-mediat/>

<http://presscouncil-ks.org/>

Lajmet e rrejshme në Kosovë, kërkim falja e drejtorëve të kompanive mediale, 2017.[Online]

<http://www.gazetaexpress.com/lajme/gazeta-express-i-kerkon-falje-dr-jusuf-ulajt-dhe-kryetarit-te-prishtines-shpend-ahmeti-186561/?archive=1>

<http://time.ikub.al/Lajme/17-06-11-Mbyllet-portali-i-lajmeve-fake-ne-Kosove198709.aspx>

Storje rreth portaleve shqiptare pro-Trump, qershor 2017.[Online]

<https://www.nytimes.com/2017/06/26/business/3-cnn-journalists-resign-after-retracted-story-on-trump-ally.html>

Studime rreth lajmeve të rrejshme, si problem i shoqërisë, 2017.[Online]

<https://telegrafi.com/lajmet-e-rrejshme-problem-shoqerise/>

<http://www.gazetadita.al/mediat-kroate-e-kosovare-mbushen-me-spekulime-mbi-babane-shqiptar-te-vucic/>

Si u pasuruan 11 portale shqiptare, investigim, mars 2017.[Online]

<http://www.gsh.al/2017/03/15/investigim-si-u-pasuruan-11-portale-shqiptare-me-sulmet-ndaj-hilari-klintonit/>

Lidhja Trump-Rusi, 2017.[Online] <https://www.theguardian.com/media/2017/jun/27/three-cnn-journalists-resign-over-retracted-trump-russia-story>

Sondazhet e zgjedhjeve, lajme të rrejshme, qershor 2017.[Online] <http://kallxo.com/lajm-rreme-per-sondazhe-ne-emer-te-institutit-gani-bobi/>

Sqarohet se ishte lajm i rremë, Driton Tali ngatërrohet me Adem Grabovcin.[Online] <http://lajmi.net/sqarohet-huqja-ishte-driton-tali-jo-adem-grabovci-qe-rrinte-me-konjufcen-dhe-kurteshin-foto/>

Kontejnerët me mbetje asgjësohen në Shqipëri, Durrës.[Online] <https://www.google.com/search?q=1300+kontenier%C3%AB+me+mbetje+t%C3%AB+rrezi+kshme+dhe+nuk+dol%C3%ABn+nga+Shqip%C3%ABria+lajm+i+rrejshem&ie=utf-8&oe=utf-8&client=firefox-b>

Mediat e reja, maj 2014.[Online] <http://www.zathur.net/mediat-e-reja/>

Zhdukja e 1300 kontejnerëve, Shqipëri, fakte të paraqitura.[Online] <http://gazetainfopress.com/aktualitete/%E2%80%8Ba-u-zhduken-1300-kontejnere-arme-kimike-ne-shqiperi>

<https://www.youtube.com/ëatch?v=VF1aufdRMr4>

The very real consequences of fake news stories and why your brain can't ignore them, dhjetor 2016.[Online] <http://www.pbs.org/newshour/updates/real-consequences-fake-news-stories-brain-cant-ignore/>

<https://www.youtube.com/watch?v=7vWNipFC-RE>

8. BIBLIOGRAFIA

McChesney. Robert Foreword (2011) “Essays on the Real Impacts of Fake News”, McFarland & Company, Inc., Publishers Jefferson, North Carolina, and London.

Couldry, Nick (2011) “*Media, Shoqëria, Bota*”. Londër

Kovach.B & Rosenstiel.T (2001).“*Elementet e Gazetarisë*”, ShBA

Group, Missouri (2005) “*Raportimi dhe Shkrimi i lajmeve*”, ShBA.

